

## 5.10 PASQYRA E NJOFTIMEVE

Ju mund t'i shikoni njoftimet, të cilat i dërgojnë mes vete përdoruesit e programit COBISS3, njoftimet që përgatiten në IZUM dhe që kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit COBISS, si dhe disa njoftime automatike (p.sh. njoftimi se raporti është dërguar në printer).

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Njoftimet / Pasqyra e njoftimeve**.



Hapet dritarja **Njoftimet**, në të cilën shfaqen njoftimet e renditura sipas datës së publikimit, që do të thotë se në krye të listës ndodhet njoftimi i publikuar së fundmi. Tek çdo njoftim shfaqet lloji i njoftimit dhe emri i përdoruesit të personit që e ka dërguar, data, koha dhe përmbajtja e njoftimit.


2. Njoftimet i fshini duke klikuar në butonin **Largo të gjitha**.
3. Për të mbyllur dritaren **Njoftimet** klikoni butonin **Mbyll**.

Njoftimet mund t'i shikoni deri sa të mos e mbyllni programin COBISS3. Në rast se programin e mbyllni dhe e hapni përsëri njoftimet fshihen.

### *Mundësitë...*

Kontrollimin e njoftimeve e mundëson edhe butoni **Njoftimet**, i cili ndodhet në shiritin e statusit të shfletuesit.

Njoftimet mund t'i kontrolloni edhe duke klikuar  në shiritin e detyrave, më pas përzgjidhni ikonën . Klikoni me tastin e djathtë të miut dhe përzgjidhni metodën **Pasqyra e njoftimeve**.

Për njoftimin nga programi COBISS3 ju paralajmëron Desktop Alert dhe ikona COBISS3 , që shfaqet në shiritin e detyrave.